# DËSHMI ARKIVI

**A-455334**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Meta: Rama delirant! Nuk njeh Gjykatën Kushtetuese as parimin e shtetit të së drejtës |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/meta-rama-delirant-nuk-njeh-gjykaten-kushtetuese-as-parimin-e-shtetit-t-i104853` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 13:33:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 13:20:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `dddf3aa30cfffcde525c247e534225644a49b1512a6aa8f92da3805cf41157a9` |
| TEKSTI | `75136b049f9d7ef6fed559226a8d8ad6d0a657fc9d2510a7ebdc2510c7219138` |
| PAMJA | `765e9cb2482442da953c515c16c3257c14fba13b2c91752ca42add228f71aa47` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2bf38ef3684199a22535790e188a4c0582fb386912420212b75f239047c20390` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2bf38ef3684199a22535790e188a4c0582fb386912420212b75f239047c20390`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Meta: Rama delirant! Nuk njeh Gjykatën Kushtetuese as parimin e shtetit të së drejtës

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 15:20



Presidenti i arrestuar i Partisë së Lirisë, Ilir Meta ka reaguar nga qelia pasi maxhoranca e qeverisë Rama miratoi mbrëmë me 84 vota formulen e re të pagave për magjistratët. Meta shpreh shqetësimin serioz edhe për një krizë tjetër absurde të krijuar midis GJKKO të Shkallës së Parë dhe Dhomës së Avokatisë, e cila dëmton rëndë parimet e mirëadministrimit të drejtësisë dhe proceset e rregullta ligjore penale.

"Miratimi dje me kokëfortësi nga Kuvendi, nën diktimin e Edi Ramës, i ligjit për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, pa konsultimin me grupin e interesit madje duke injoruar edhe Shoqatën Europiane të Gjyqtarëve, është tregues i papërgjegjshmërisë totale të një deliranti, i cili nuk njeh as Gjykatën Kushtetuese dhe asnjë parim të shtetit të së drejtës.

Të gjitha mosveprimet e Kuvendit në kohën e përcaktuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, tregojnë qartë që kanë qenë me dashje dhe të diktuara nga Edi Rama, po ashtu si injorimi që iu bë përmbajtjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese dje. Detyrimet e marra nga Kuvendi i Republikës në vitin 2016 për statusin dhe pagat e sistemit gjyqësor, si garanci për dinjitetin dhe pavarësinë e tyre duhen përmbushur pa asnjë devijim, bullizim dhe diskriminim nga Qeveria, që dikton edhe Kuvendin e nënshtruar tërësisht dhe jofunksional.

Po kështu, dua të shpreh shqetësimin serioz për një krizë tjetër absurde të krijuar midis GJKKO të Shkallës së Parë dhe Dhomës së Avokatisë, e cila dëmton rëndë parimet e mirëadministrimit të drejtësisë dhe proceset e rregullta ligjore penale. Është i domosdoshëm dialogimi midis këtyre institucioneve për t'i dhënë fund sa më parë kësaj krize të panevojshme midis këtyre dy institucioneve.

Është e paarsyeshme, arbitrare, joproporcionale që avokatët të vendosin midis dy presioneve, pra nga njëra anë nga Dhoma e Avokatisë dhe nga ana tjetër nga GJKKO e Shkallës së Parë.

Ndaj mbizotërimi i parimit të procesit të rregullt ligjor duhet të përcaktojë tejkalimin e këtij ngërçi të papritur, të dëmshëm për të gjithë aktorët dhe të panevojshëm."- shkruan Meta.

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 18 Shtator14:56

### "Fati politik i Ballukut është mbyllur"/ Këlliçi: SPAK do t'i drejtohet sërish Kuvendit këto ditë

Deputeti demokrat, Belind Këlliçi komentoi miratimin e ligjit për pagat e magjistratët si dhe çështjen e Belinda Ballukut, i...

POLITIKE 18 Shtator11:37

### Me dorën mbi Kushtetutë, betohet te Presidenti Begaj ministri i ri i Brendshëm, Ervin Demo

Me dorën mbi Kushtetutë, betohet te Presidenti Begaj ministri i ri i Brendshëm, Ervin Demo. Ashtu siç ishte njoftuar, sot në Presi...

POLITIKE 18 Shtator11:28

**Begaj dekretoi brenda pak orësh ligjin për pagat e magjistratëve, Bardhi: Asnjë surprizë nga roja e godinës së Parlamentit!**

Kreu i grupit parlamentar të PD, Gazment Bardhi, ka reaguar pas dekretimit të ligjit për pagat e magjistratëve, që u votua mbrëm...

POLITIKE 18 Shtator11:10

**"Situatë alarmante me koncesionet"/ Grupi Parlamentar i PD-së propozon paketë ligjore që të gjurmojë fondet publike**

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka ndërmarrë një hap zyrtar në Kuvend duke depozituar një paketë të re ligjore...

POLITIKE 18 Shtator10:52

**"Provo dil, të tërheqin zvarrë"/ Tabaku i kujton Ramës 110 ditë protesta: Mos trego arrogancë, por jep dorëheqjen**

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, iu drejtua kryeministrit Edi Rama gjatë replikës së saj në Kuvend ditën e djeshm...

POLITIKE 18 Shtator10:47

**'Rama si monark, baronët mbledhin taksat', Hasimja: 'Kayo' në Shëndetësi, monopolizim e feudalizëm**

Për analistin dhe politologun Ermal Hasimja, ardhja e Klodiana Spahiut në krye të Ministrisë së Shëndetësisë, ësh...

POLITIKE 18 Shtator10:37

**Bardhi "shpërthen" në akuza ndaj Ramës: Ka projektuar një shtet privat. Po hakmerret ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, s'e i kanë trokitur te dera për Belindën!**

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka replikuar ashpër në Kuvend me kryeministrin Edi Rama për lig...

POLITIKE 18 Shtator10:29

**'Djali i Pankartës', Ani Marku tregon detaje nga shoqërimi: Pankarta simbol kombëtar, ofenduese si e hodhën**

I njohur tashmë nga qytetarët si 'Djali i Pankartës', Ani Marku ka dhënë detaje nga shoqërimi i tij në komisari...

POLITIKE 18 Shtator09:58

**'Performanca' e Klodiana Spahiut në Kuvend/ Alimehmeti: Humbje qetësie! A është modeli 'Kayo' mision?!**

Drejtuesi i Departamentit të Shëndetësisë në PD, Ilir Alimehmeti ngre dyshime të forta mbi emërimin e Klodiana Spahiut n&eu...

POLITIKE 18 Shtator09:19

**12 orë debat/ Nga KAYO te miratimi i drafti për pagat e magjistratëve, çfarë ndodhi në seancën maratonë në Kuvend**

Kuvendi u mblodh në seancë plenare ditën e djeshme, (17 shtator 2026), në një seancë maratonë që zgjati më shum&e...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 17 Shtator

**Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jet...**

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator

**Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën j...**

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

BOTA 17 Shtator

**I veshur si grua, 33-vjeçari 'tradhtohet' dhe a...**

Ai pothuajse ia kishte dalë, por një tatuazh e tradhtoi. Jordan Lopes da Silva, 33 vjeç, ishte maskuar si grua, duke vendosur një paruke, ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

**Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

**video**



**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.